LIGJ
Nr.9346, datë 17.2.2005

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7973, DATË 26.7.1995 "PËR KONCESIONET DHE PJESËMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT NË SHËRBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

"11. Në shërbime të caktuara në administratën publike, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Në paragrafin e parë të nenit 4, pas fjalëve "në pikat 2, 3, 4, 7, 8, 9 dhe 10" shtohet pika "11".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4499, datë 28.2.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu